

**EMANTE sh.p.k**

**Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më  
31 Dhjetor 2020**

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 1. Informacion i përgjithshëm

EMANTE sh.p.k, është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 24.02.2006 . Kapitali regjistruar është 363.000.000 dhe zotërohet nga ortakët i vetëm themelues Z..Hekuran Brahimaj 100 % .

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë për ushtrimin 2020 është :

Import-eksport, tregti të materialeve ndërtimore, panele, profile hekuri dhe plastik, import eksport dhe tregëtim me shumice dhe pakice të mallrave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqësore, materiale të ndërtimit etj. Përpunim të llamarinës kryesisht prodhim aksesorë llamarine. Prodhimi, montimi dhe shërbimi i vendosjes së kioskave me panele sanduic. Import-eksport i elektroshtepiave, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve të palestres, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik si dhe lende druri. Tregti me shumice dhe pakice i elektroshtepiave, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve të palestres, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik si dhe lende druri. Transportimi i materialeve ndërtimore, panele, profile hekuri dhe plastike, mallrave industriale, ushqimore, blegtorale, bujqësore, i elektroshtepiave, hidrosanitareve, mobiljeve, elektrikeve, kondicionereve, paisjeve të palestres, artikuj sportiv, linoleum inxhinierik, lende druri si dhe të kioskave me panele sandwich.

Adresa kryesore e regjistruar e Shoqërisë është Vore, Muçaj, Rruga Industriale, Nd.61, Muçaj, 1053 , Tirane.

Kompania ushtron veprimtarinë e saj edhe në këto adresa të tjera:

- Tirane Vore , Automjet me targe AA 274 CZ
- Tirane Vore , Rruga Industriale, Ndertesa Nr.61, Muçaj, 1053, Vore, Km 13

Z.nj .Flutura Brahimaj është Administratore e Përgjithshme e Shoqërisë.

Shoqëria i ofron produktet dhe shërbimet e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Më 31 Dhjetor 2020 kompania kishte të punësuar 41 punonjës

### 2. Përmbledhje e Politikave kryesore kontabël

#### 2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK)

#### 2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.3 Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.4 Vlerësime dhe gjykime

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, drejtimi ka kryer gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël të Shoqërisë, njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar më poshtë.

*Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit fitimit në Shqipëri. Ajo i njeh detyrimet për çështjet e lidhura me kontrollet e pritura tatimore, duke u bazuar në vlerësime për tatime shtesë të pagueshme. Kur rezultati tatimor final i këtyre çështjeve është i ndryshëm nga shumat që janë regjistruar fillimisht, këto diferencat do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet tatimore të periudhës dhe ato të shtyra në periudhën në të cilën bëhet ky përcaktim.

### 3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve ku specifikohet ndryshe.

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga këmbimi për zërat monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë këmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në fitim ose humbje.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Euro/Lek	123.7	121.77
USD/Lek	100.84	108.64

### 3.2 Instrumentet financiarë

Instrumentet financiarë jo-derivative përbëhen nga llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, huamarrje, dhe llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

Instrumentet financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentet financiarë jo-derivative maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre*

Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare ekuivalentë të tyre përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

#### *Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihet kur ka të dhëna objektive se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet sipas termave origjinale të të arkëtueshmeve. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaria e arkëtueshme me atë debitor është e zhvlerësuar. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

#### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Huamarrjet*

Huamarrjet njihen fillimisht me kosto dhe mbahen në vazhdim me vlerën e drejtë, neto nga kosto e transaksioneve.

#### *Të tjera*

Instrumente të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

#### *Vlera e drejtë*

Vlera kontabël për mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre, llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme, llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme, huamarrje, supozohet të përafrojë me vlerën e tyre të drejtë.

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Kapitali i paguar

Kapitali i paguar njihet me vlerën nominale.

### 3. Politikat të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### 3.3 Aktivet Afatgjata Materiale

##### (i) Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, nëse ka.

Kosto përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte (nëse ka), çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Punime ndërtimi në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen për vlerën neto në "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të tij nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

##### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, për të gjitha aktivet, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Përmirësimet e aktiveve të marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktiveve rishikohen respektivisht në çdo datë raportimi.

Metodat e amortizimit dhe përqindjet përkatëse sipas grupeve të aktiveve afatgjata për periudhën aktuale janë si mëposhtë:

Mjete transporti	20% mbi vlerën kontabël neto
Pajisjet informatike	25% mbi vlerën kontabël neto
Mobilje dhe pajisje zyre	20% mbi vlerën kontabël neto

### 3. Politikat të rëndësishme kontabël (vazhdim)

#### 3.4 Inventarët

Inventarët njihen fillimisht me koston historike të tyre dhe më pas vlerësohen me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera për sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet e tyre aktuale dhe matet me metodën e kostove standarde.

#### 3.5 Zhvlerësimi

##### (i) Aktivet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive që tregon se një apo më shumë ngjarje kanë pasur një efekt negativ mbi flukset monetare të ardhshme të atij aktivi. Një humbje nga rënia në vlerë e një aktivi financiar e matur me koston e amortizuar llogaritet si ndryshim midis vlerës së tij kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim mbi baza individuale. Aktivët e mbetura financiare vlerësohen në mënyrë kolektive në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo humbje e akumuluar në lidhje me një aktiv financiar të vlefshëm për shitje të njohur më parë në kapital transferohet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar rimarrja njihet në fitim ose humbje.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktiviteti tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

### 3.6 Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme dalëse të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për rreziqet që lidhen me një detyrim të pasigurt në kohë dhe vlerë. Rimarrja e provigjionit njihet në të ardhurat e tjera në momentin kur ngjarja e cila ishte shkak i njohjes së provigjionit plotësohet. Njohja e provigjioneve dhe rimarrja e tyre trajtohen si shpenzime të pazbritshme/ardhura të pa tatueshme për qëllime të tatimit fitimit në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, duke mos pasur asnjë efekt në llogaritjen e shpenzimit të tatimit fitimit për periudhën.

### 3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shitja e produkteve në rrjedhën e aktiviteteve të zakonshme maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga zbritjet dhe nga taksat e lidhura me shitjet. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në proporcion me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e bilancit.

### 3.8 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga depozitat bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit ose humbjes, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes me metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%.

## 4. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse që shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe paraja në arkë në valutë dhe në monedhë vendase. Mjetet monetare më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
<i>Arka</i>		
Arka në LEK	338,844	540,576
	<b>338,844</b>	<b>540,576</b>
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse në LEK	1,025,826	5,325,973
Llogari rrjedhëse në EUR	450,085	41,475,237
Llogari rrjedhëse në USD	96,742	67,585
	<b>1,572,653</b>	<b>46,868,795</b>
<b>Total Mjete Monetare</b>	<b>1,911,497</b>	<b>47,409,371</b>

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 5. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga vlera e të drejtave të shoqërisë ndaj të tretëve të cilët nuk kanë shlyer ende detyrimin deri në datën e ndërtimit të pasqyrave financiar. Më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 llogaritë e arkëtueshme janë krijuar si mëposhtë:

	2020	2019	
Gjendje e klientëve në fillim të vitit	128,611,449	110,161,592	1:
Krijuar gjatë vitit	490,686,205	490,797,175	4:
Arkëtuar gjatë vitit	482,275,602	472,347,318	4:
<b>Gjendje e klientëve në fund të vitit</b>	<b>137,022,052</b>	<b>128,611,449</b>	<b>1:</b>

### 6. Aktive tatimore të shtyra (Të tjeratë arkëtueshme)

Të tjera të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
TVSH e zbritshme	4,491,065	14,279,548
Tatim mbi fitimin	6,852,781	3,333,908
Paguar tepër në doganë		178,000
<b></b>	<b>11,343,846</b>	<b>17,791,456</b>

### 7. Inventarët

Inventarët më 31 Dhjetor 2020 dhe 2018 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Lëndë e parë	26,066,298	20,538,878
Produkt i gatshëm	5,620,057	2,693,849
Mallra për rishitje	32,036,782	30,897,633
<b></b>	<b>63,723,137</b>	<b>54,130,360</b>

#### Lëndë e parë

	2020	2019
Inventar gjendje në fillim të vitit	20,538,878	24,531,162
Blerë gjate vitit	99,442,611	104,679,501
konsumuar gjate vitit	93,915,191	108,671,785
Inventar gjendje në fund të vitit	26,066,298	20,538,878

#### Produkti i gatshëm

	2020	2019
Inventar gjendje në fillim të vitit	2,693,849	1,452,783
Blerë gjate vitit	130,794,394	170,103,248
Shitur gjate vitit	127,868,186	168,862,182
Inventar gjendje në fund të vitit	5,620,057	2,693,849

## EMANTE sh.p.k

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### Mallra për rishitje

	2020	2019
Inventar gjendje në fillim të vitit	30,897,633	26,559,214
Blerë gjate vitit	262,106,743	205,213,504
Shitur gjate vitit	260,967,594	200,875,085
Inventar gjendje në fund të vitit	32,036,782	30,897,633



# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 8. Aktive afatgjata materiale

Aktive afatgjata materiale më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mobilje dhe orendi	Kompjuterë dhe pajisje informatike	Automjete	Total
<b>Kosto</b>							
<b>Balanca ne 1 janar 2019</b>	<b>29,609,800</b>	<b>10,894,162</b>	<b>26,422,853</b>	<b>388,361</b>	<b>994,023</b>	<b>23,254,034</b>	<b>91,563,233</b>
Shtesa	-	-	694,574	0	-	335,500	1,030,074
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2019</b>	<b>29,609,800</b>	<b>10,894,162</b>	<b>27,117,427</b>	<b>388,361</b>	<b>994,023</b>	<b>23,589,534</b>	<b>92,593,307</b>
Shtesa	-	-	63,956,920	0	283,867	0	64,240,787
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2020</b>	<b>29,609,800</b>	<b>10,894,162</b>	<b>91,074,347</b>	<b>388,361</b>	<b>1,277,890</b>	<b>23,589,534</b>	<b>156,834,094</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>							
<b>Balanca 1 janar 2019</b>	-	<b>758,597</b>	<b>6,798,431</b>	<b>74,531</b>	<b>312,310</b>	<b>5,477,155</b>	<b>13,421,024</b>
Shpenzimi i periudhës	-	506,778	3,924,884	62,776	170,428	3,555,376	8,220,242
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>1,265,375</b>	<b>10,723,315</b>	<b>137,307</b>	<b>482,738</b>	<b>9,032,531</b>	<b>21,641,266</b>
Shpenzimi i periudhës	-	481,439	3,278,822	50,211	127,821	2,911,401	6,849,694
Pakësime	-	-	-	-	-	-	-
Riklasifikime	-	-	-	-	-	-	-
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>1,764,814</b>	<b>14,002,137</b>	<b>187,518</b>	<b>610,559</b>	<b>11,943,932</b>	<b>28,490,960</b>
<b>Vlera neto</b>							
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2019</b>	<b>29,609,800</b>	<b>9,628,787</b>	<b>16,394,112</b>	<b>251,054</b>	<b>511,285</b>	<b>14,557,003</b>	<b>70,952,041</b>
<b>Balanca ne 31 Dhjetor 2020</b>	<b>29,609,800</b>	<b>9,147,348</b>	<b>77,072,210</b>	<b>200,843</b>	<b>667,331</b>	<b>11,645,602</b>	<b>128,343,134</b>

## EMANTE sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 (shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

#### 9. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme për vitin 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	2020	2019
Gjendje e furnitoreve në fillim të vitit	31,984,380	152,607,431
Krijuar gjate vitit	454,806,612	380,553,882
Likujduar gjate vitit	427,277,996	501,176,837
Gjendje e furnitoreve në fund të vitit	59,512,996	31,984,476

#### 10. Llogari të tjera të pagueshme

Llogari të tjera të pagueshme më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Te pagueshme ndaj përonjesve	0	0
Sigurime shoqërore të pagueshme	661,936	479,186
Tatimi mbi të ardhurat personale	159,016	97,631
Tatim në burim	15,675	15,675
Detyrime tatimore per TVSH	0	0
Dividende per t'u paguar		
	<b>836,627</b>	<b>592,492</b>

#### 11. Huatë

Huatë më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Huamarrje aftagjata	40,818,121	50,806,060
Detyrime ndaj institucioneve te kredise (Overdraft bankar)	30,925,000	27,050,760
	<b>71,743,121</b>	<b>77,856,820</b>

Pershkrim kur jane marre

- Më 29 gusht 2019, Shoqëria ka marrë një linjë kredie nga banka e niveli të dytë Procredi Bank sha në vlerën 350,000 Euro(për t'u përdorur në investimin që po realizon shoqëria. Shlyerja e kredisë do të bëhet brenda një periudhe 60 (Gjashtedhjetë ) mujore, nëpërmjet pagesave mujore. Norma efektive e interesit të aplikuar është 3.5% në vit dhe njihet si detyrim afatgjatë.
- Huaja e marre nga Banka Kombetare Tregtare është kredi shtate vjecare me e cila është përdorur për zhvillimin e aktivitetit. Nga drejtimi ajo është klasifikuar si afatgjat. Nga të cilat dy janë të mbyllura në Maj të 2019 dhe një vazhdon sipas pershkrimit deri në vitin 2022 .

Aneksi i planit të pageses 1- BKT:
Fillimi: 21.05.2014
Mbyllja: 21.05.2019
Shuma e kredisë: 14,000,000 leke
Norma aktuale e Interesit: 7
Norma efektive e Interesit: 7.78

Aneksi i planit të pageses 2- BKT:

## EMANTE sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Fillimi: 21.05.2014
Mbyllja: 21.05.2019
Shuma e kredise: 1,000,000 leke
Norma aktuale e Interesit: 7
Norma efektive e Interesit: 7.78

Aneksi i planit te pageses 3- BKT:
Fillimi: 25.05.2015
Mbyllja: 25.05.2022
Shuma e kredise: 150,000 euro
Norma aktuale e Interesit: 4
Norma efektive e Interesit: 4.39

Po kështu shoqëria ka në përdorim edhe një overdraft në vlerën e 30,925,000 lekë nga banka Pro Credit Sha ..

#### Garancitë

Garancia e ofruar nga shoqëria (kredimarrësi) përkundrejt kredisë konsiston në vendosjen e barrës hipotekore në favor të Kredithënësi.

## 12. Kapital i paguar dhe rezervat

### A. Kapitali I paguar

Kapitali i paguar nga ortakët e Shoqërisë më 31 Dhjetor 2020 është 363,000,000 lekë. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, pjesëmarrja në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar përfaqësohet nga ortakët të cilët zotërojnë vetëm një kuotë. Kuota përfaqëson pjesëmarrjen e ortakëve në kapitalin e shoqërisë dhe secila kuotë përfaqëson një të drejtë votimi në përpjesëtim me përqindjen e pjesëmarrjes. Struktura e kapitalit është e përbërë nga 1 kuotë me vlerë 363,000,000 lekë që zotërohet nga ortaku i vetëm.

Ortakët e Shoqërisë janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2020			31 Dhjetor 2019		
	Numri i kuotave	Pjesëmarrja %	Mijë Lek	Numri i kuotave	Pjesëmarrja %	Mijë Lek
Hekuran Brahimaj	1	100%	363.000,000	1	100%	363,000,000
<b>Total</b>	<b>1</b>	<b>100%</b>	<b>363.000,000</b>	<b>1</b>	<b>100%</b>	<b>363,000,000</b>

### B. Rezervat

Më 31 Dhjetor 2020, Rezervat statuoare janë 7,402,176 , rezervat ligjore 6,102,741 , rezervat te tjera 11,859,833 leke.

### C. Dividendët

Ortaku ka të drejtën e marrjes së dividendit të deklaruar dhe kanë të drejtë vote në mbledhjet e përgjithshme të Shoqërisë nëpërpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapital, e përfaqësuar nga kuota. Të drejtat e votës nëpërpjesëtim me pjesën e kapitalit të paguar të shoqërisë renditen në mënyrë të barabartë në raport me aktivet e mbetura të shoqërisë.

## 13. Të ardhurat

Të ardhurat për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

## EMANTE sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Mallra të tregtuar	406,373,758	419,531,813
	<b>406,373,758</b>	<b>419,531,813</b>

#### 14. Shpenzime për materiale

Shpenzimet për materiale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Kosto e mallrave për rishitje	(320,949,388)	(286,425,828)
	<b>(320,949,388)</b>	<b>(286,425,828)</b>

#### 15. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Pagat	(22,211,794)	(21,436,330)
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	(3,709,368)	(3,565,070)
	<b>(25,921,162)</b>	<b>(25,001,400)</b>

#### 16. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera për fundin e vitit 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhet si më poshtë:



## EMANTE sh.p.k

### Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Bl.energji.avull.ujë	1.246.686	1.715.926
Lende djegese Shpz nafte	1.677.120	
Montim nga te tretet		7.157.417
Sherbim nga te tretet		40.000
Sherbime per instalime elektrike dhe Hidraulike	710.750	1.651.667
Sherbime per Projektin IOM		2.464.000
Qira	1.112.400	1.112.400
Mjeku i kompanise	141.600	141.600
Trajtime te pergjithshme		
Mirembajtje dhe riparime	481.281	220.674
Te tjera	5.511.980	13.037.229
Shpenzime Noteriale	20.038	
Studime dhe kerkime	3333	
Shpenzime per Licensa, patenta dhe rregjistrim Marke	367.756	
Shpenzime pa fature		332.441
Personel Jashte ndermarjes	160.000	
Shpenzim-sigurim privat		684.000
Shpenzim tarife sherbimi		11.301.783
Publicitet , reklama	69.312	341.683
Transferime, udhetim, dieta	81.528	82.185
Shpz.postare e telekom.	543.117	456.936
Transport per Blerje	104.590	
Transporte per shitje	896.254	9.991.900
Sherbime bankare	421.586	477.936
Sherbime Dogana Tatim ne Burim		59.726
Shpenzim police sigurimi		169.306
Sherbime Bashkpronesie	56.000	
Taksa dhe tarifa vendore	773.683	187.646
Taksa e Rregjistrimit		10.000
Tatime te tjera	874.328	1.372.974
Shpenzime Sponsorizimi		
Gjoha dhe demshperblime	108.663	87.194
Shpenzime te tjera	<u>328.393</u>	<u>204.478</u>
	<b>15,690,399</b>	<b>53,301,103</b>

#### 17. Të ardhurat dhe shpenzimet e tjera financiare

Të ardhurat nga interesi për fundin e vitit 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen nga:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2018
Të ardhura te tjera financiare	0	432,005
Shpenzime interesi	(2,914,952)	(2,452,817)
	<b>(2,914,952)</b>	<b>(2,020,812)</b>

#### 18. Fitim/(humbjet)nga kurset e këmbimit, neto

Fitim/(humbjet) nga kurset e këmbimit, neto për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

# EMANTE sh.p.k

## Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(shumat në Lek, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Fitimet nga diferencat në kurset e këmbimit	0	0
Humbjet nga diferencat në kurset e këmbimit	(43,314)	(1,345,067)
	<b>(43,314)</b>	<b>(1,345,067)</b>

### 19. Tatim mbi fitimin

Norma e tatimit mbi fitimin e Shoqërisë është 15% për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimore mbeten provizore deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Legjislacioni tatimor shqiptar është objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019
Fitimi para tatimit	36,620,899	44,458,427
Plus: Shpenzimet e pazbritshme	433,981	291,673
Humbjet tatimore të mbartura	-	-
<b>Fitimi i tatueshëm për vitin</b>	<b>37,054,880</b>	<b>44,750,100</b>
<b>Tatimi mbi fitimin (15%)</b>	<b>5,558,232</b>	<b>6,712,515</b>
<b>Fitimi i vitit finciare</b>	<b>31,062,667</b>	<b>37,745,912</b>

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Tatim fitimi në celje	3,333,908	8,980,863
Tatim fitimi i parapaguar gjatë vitit	3,518,873	1,065,560
Tatim fitimi i vitit	-5,558,232	-6,712,515
<b>Detyrimi tatimor për tatim fitimin</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Tatim fitimi i paguar tepër</b>	<b>1,294,549</b>	<b>3,333,908</b>

Administratori i shoqërisë:

Flutura Brahimaj

*Flutura Brahimaj*

